



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**

**KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

20.02.2021

Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar

**TEZA 5**

**ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)**

**1. Kur një shoqëri kryehen një vlerësim për zhvlerësimin e aktiveve afatgjata, ato maten me shumën e tyre të rikuperueshme. Cila prej këtyre opsioneve përshkruan shumën e rikuperueshme?**

- a. Më e larta midis vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim;
- b. Më e larta midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit;
- c. Më e larta midis vlerës kontabël minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës së drejtë;
- d. Më e larta midis vlerës kontabël minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim;
- e. Më e ulëta midis vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerën në përdorim;
- f. Më e ulëta midis vlerës kontabël minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim;
- g. Më e ulëta midis vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël;
- h. Më e ulëta midis vlerës së drejtë, vlerës kontabël dhe vlerës në përdorim.

**Përgjigja e saktë është alternativa A**

**2. Cili nga indikatorët e mëposhtëm NUK përbën një indikator për zhvlerësim sipas përcaktimeve të SNK 36 ‘Zhvlerësimi i Aktiveve’:**

- a. Avancimet e shpejta në mjedisin teknologjik kanë një impakt negativ në përdorimin e ardhshëm të një aktivi digjital të njësisë ekonomike;
- b. Rritja e normave të interesit ka çuar në rritje të normës së zbritjes të përdorur nga njësia ekonomike;
- c. Vlera neto e aktiveve të njësisë ekonomike është me e lartë sesa numri e aksioneve të emetuara nga shoqëria, shumëzuar me çmimin e aksionit;
- d. Vlera e neto e realizueshme e inventarit është reduktuar ndjeshëm për shkak të dëmeve të shkatuara nga zjarri, edhe pse kjo vlerë është më e lartë se vlera kontabël;
- e. Një rënie e përgjithshme e cmimit të pronës në zonë ka çuar në rënie të shumës së rikuperueshme të ndërtesës nën vlerën kontabël;
- f. Vlera kontabël e emrit të mirë për një njësi të gjenerimit të parasë është vlerësuar në fund vitit dhe ka rezultuar më e ulët sesa shuma e rikuperueshme e njësisë të gjenerimit të parasë;

- g. Rënia e ndjeshme e vlerës së tregut të një ose më shume aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë;
- h. Kriza si pasojë e Covid-19 ka patur një impakt negativ në flukset monetare hyrëse të njësisë ekonomike duke cuar në një performancë financiare ndjeshëm më të ulët se parashikimet.

### **Përgjigja e saktë është alternativa D**

**3. Shoqëria 'Parku i Aventurës' shpk ofron shërbime argëtimi përmes sporteve dhe lojrave në natyrë për të rritur dhe fëmijë. Një nga klientët rrëzohet dhe dëmtohet gjatë një aktiviteti në park, duke hedhur kështu në gjyq shoqërinë përkundrejt një pretendimi në vlerën 2.5 milion Lekë. Avokati i shoqërisë mendon se mundësia e humbjes së çështjes gjyqësore është 55%. Kostot që shoqëria do t'i paguajë avokatit janë 400,000 Lekë. Cila është vlera e detyrimit që duhet të njohë shoqëria lidhur me këtë rast.**

- a. 2,900,000 Lekë;
- b. 1,595,000 Lekë
- c. 2,500,000 Lekë;
- d. 1,375,000 Lekë;
- e. 1,775,000 Lekë;
- f. 400,000 Lekë, pra vetëm detyrimin e pagueshëm ndaj avokatit për shërbimin ligjor;
- g. Asnjë detyrim pasi probabiliteti i humbjes së çështjes gjyqësore nuk është i mjaftueshëm për të njohur një detyrim;
- h. Të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të vlerësuar në mënyrë të besueshme vlerën e detyrimit në pasqyrat financiare të shoqërisë.

### **Përgjigja e saktë është alternativa A**

**4. Cila nga aktivet e mëposhtme në pronësi të shoqërisë Gama shpk përbën një aktiv material afatgjatë të investuar në përputhje me SNK 40?**

- a. Një pronë që i ishte dhënë me qira një qiramarrësi, por që nuk kërkohet më për qiramarrje dhe tani po mbahet për rishitje;
- b. Një tokë e blerë nga shoqëria për shak të potencialit të saj si investim. Shoqëria nuk ka marrë ende leje për të ndërtuar mbi këtë pronë.
- c. Një ndërtesë e sapo blerë nga shoqëria t'u përdorur në të ardhmen si aktiv afatgjatë material i investuar;
- d. Një ndërtesë e re e përdorur aktualisht si zyra qendrore e Gama Shpk, e blerë posaçërisht në mënyrë që të shfrytëzohet potenciali i saj për të gjeneruar fitime kapitale në të ardhmen;
- e. Një pronë e përdorur nga shoqëria për qëllime të trajnimit të stafit ekzekutiv të shoqërisë;
- f. Një pronë e dhënë me qira nga Gama Shpk një tjetër shoqërie në formën e një qiraje financiare;
- g. Një pronë e sapo blerë nga shoqëria GamaFo Shpk e blerë posaçërisht për rishitje në të ardhmen për shkak të sinjaleve të rritjes së vlerës së tregut të pronës në zonën ku operon shoqëria;
- h. Dy apartamente rezidenciale të blera për qëllime të akomodimit afatgjatë të stafit ekzekutiv të huaj. Cmimi i tregut të këtyre apartamenteve është rritur ndjeshëm në dy vitet e fundit.

### **Përgjigja e saktë është alternativa B**

5. Shoqëria ABC ka blerë në një kombinim biznesesh një markë tregtare që pritet të ketë një jetë të pacaktuar. Vlera kontabël e markës tregtare është 750,000 Lekë. Më 31 dhjetor 2020, vlera e drejtë e markës tregtare është 600,000 Lekë. Vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme është 630,000 Lekë dhe shuma e paskontuar e flukseve monetare të ardhshme është 700,000 Lekë. Kostot e shitjes së markës janë të parëndësishme. Trajtimi kontabël në rastin e markës tregtare në përgatitjen e PF sipas SNK 36 dhe SNK 38 do të jetë:
- Marka do të njihet me vlerën e saj kontabël;
  - Marka do të njihet me vlerën e flukseve monetare të ardhshme në vlerën 700,000 Lekë;
  - Marka do të njihet me vlerën e drejtë prej 600,000 Lekë dhe kjo sjell njohjen e një humbje nga zhvlerësimi 150,000 Lekë;
  - Marka do të njihet si shpenzim meqënëse jeta e saj është e pacaktuar;
  - Marka do të njihet me vlerën aktuale të flukseve të ardhshme 630,000 dhe kjo sjell njohjen e një humbje nga zhvlerësimi 120,000 Lekë;
  - Marka do të njihet si pjesë e emrit të mirë të krijuar nga shoqëria ABC;
  - Marka do ti bashkohet vlerës së aktiveve afatgjatë me të cilët ajo ka lidhje direkte;
  - Asnjëra.

**Përgjigja e saktë është alternativa E**

6. Sipas kërkesave të SKK 8, të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar kushtet e mëposhtme:
- Njësia ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;
  - Kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri;
  - Është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësia ekonomike;
  - Njësia ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;
  - Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
  - a, b, c dhe e;
  - b, c dhe e;
  - a, b, c, d dhe e.

**Përgjigja e saktë është alternativa H**

7. Sipas kërkesave të SKK 9, për çdo kombinim biznesi që kryhet gjatë periudhës, blerësi do të japë informacione në shënime shpjeguese në vijim:
- Datën e blerjes;
  - Shumat e njohura në datën e blerjes për çdo klasë të aktiveve të njësisë së blerë, detyrimet dhe detyrimet e kushtëzuara, duke përfshirë emrin e mirë;
  - Përqindjen e instrumenteve të kapitalit të zakonshëm të blerë;

- d. Shumat e tepërta të njohura në fitim ose humbje, dhe nën-zërin në pasqyrën e të ardhurave në cilin është njohur teprica (tejkalimi mbi koston e interesit të blerësit në vlerën e drejtë neto të aktiveve të identifikueshme të njësisë ekonomike të blerë, të detyrimeve aktuale dhe të kushtëzuara);
- e. Koston e kombinimit dhe një përshkrim të përbërësve të kësaj kostoje (si mjete monetare, instrumente kapitali dhe instrumente borxhi);
- f. Emrat dhe përshkrimet e njësive ekonomike ose bizneseve të kombinuara
- g. a, b, c, d, e dhe f
- h. a, b, c, d, dhe f

### **Përgjigja e saktë është alternativa G**

#### **8. Sipas kërkesave të SKK 11, diferencat e përkohshme lindin:**

- a. Kur, pas njohjes, lind një diferencë mes vlerës kontabël dhe bazës tatimore, për shkak se e ardhura ose shpenzimi njihet në kapital në një periudhë raportuese të caktuar, ndërkohë që në fitimin e tatueshëm njihet në një periudhë raportuese tjetër;
- b. Kur, baza tatimore e një aktivi ose detyrimi ndryshon dhe ndryshimi nuk ndikon në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit, në asnjë periudhë raportuese;
- c. Kur, në njohjen e aktiveve ose detyrimeve, ka një diferencë mes vlerave kontabël dhe bazave tatimore të tyre, ose kur krijohet një bazë tatimore (për ato zëra që kanë një bazë tatimore) por nuk njihet asnjë aktiv apo detyrim;
- d. Aktivët rivlerësohen ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon;
- e. Kostoja e një kombinimi biznesesh shpërndahet mbi bazën e vlerës së drejtë të aktiveve të identifikueshme të blera/përfuara dhe të detyrimeve të marra, ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon;
- f. a,b,c,d dhe e;
- g. b, c dhe d;
- h. a, c, dhe e.

### **Përgjigja e saktë është alternativa F**

#### **9. Sipas kërkesave të SKK 12, në fund të çdo periudhe raportuese, një njësi ekonomike duhet:**

- a. Të përkthejë zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë;
- b. Të përkthejë zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (pra. në datën raportuese);
- c. Të përkthejë zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (pra. në datën raportuese);
- d. Të përkthejë zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit;
- e. Të përkthejë zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit;
- f. b, c dhe e;
- g. a,c dhe d;
- h. a, c, dhe e.

**Përgjigja e saktë është alternativa G**

**10. Sipas kërkesave të SKK 14, ekzistenca e ndikimit të ndjeshëm, në lidhje me pjesëmarrjet, karakterizohet nga faktorët e mëposhtëm:**

- a. Shkëmbimi i informacionit teknik, mes njësisë që investon dhe njësisë ku është kryer investimi;
- b. Ndërshkëmbim i personelit drejtues, mes njësisë që investon dhe njësisë ku është kryer investimi;
- c. Transaksione materiale mes njësisë që investon dhe njësisë ku është kryer investimi;
- d. Pjesëmarrje në vendimet mbi hartimin e politikës së biznesit të njësisë ku është kryer investimi;
- e. Përfaqësimi në drejtim ose në organin më të lartë të mbikëqyrjes;
- f. a, b, c, d dhe e;
- g. b, c dhe e;
- h. a, b, c dhe e.

**Përgjigja e saktë është alternativa F**

## PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Bordi i Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit (BSNK) përcakton përkatësinë dhe paraqitjen besnike si dy nga karakteristikat cilësore themelore të informacionit në Kuadrin Konceptual.

### Kërkohet:

Për secilën nga karakteristikat cilësore të mëposhtme tregoni nëse janë karakteristika të paraqitjes besnike apo përkatësisë si dhe arsyet.

	Paraqitja Besnike	Përkatësia
Plotësia		
Vlera parashikuese		
Neutraliteti		

### Zgjidhje:

	Paraqitja Besnike	Përkatësia
Plotësia	✓ <input type="checkbox"/>	
Vlera parashikuese		✓ <input type="checkbox"/>
Neutraliteti	✓ <input type="checkbox"/>	

Që të ketë një paraqitje besnike, informacioni financiar duhet të ketë tre karakteristika. Ai duhet të jetë i **plotë**, **neutral** dhe pa gabime. Pra, plotësia dhe neutraliteti janë karakteristika të paraqitjes besnike.

Vlera parashikuese është një karakteristikë cilësore e përkatësisë. Informacioni financiar bën të mundur një ndryshim në vendime nëse ai ka **vlerë parashikuese**, vlerë konfirmuese ose të dyja.

(1 pikë për përcaktim të saktë dhe 1 pikë për cdo arsyetim të drejtë për secilën prej tre karakteristikave cilësore të mësipërme).

2. Shoqëritë *Drini* dhe *Buna* operojnë në sektorin e tregimit të materialeve të ndërtimit dhe atyre hidraulike/sanitare. Të dyja shoqëritë kanë një pozicion të konsoliduar në këtë treg dhe janë tashmë në fazën e maturimit. Më poshtë jepen disa tregues kryesorë të analizës së kryer për to nga konsulenti financiar për tre vitet e fundit ushtrimore.

	Shoqëria Drini			Shoqëria Buna		
	2019	2018	2017	2019	2018	2017
Raporti i borxhit total	61%	62%	67%	55%	52%	56%
Raporti i detyrimeve financiare ndaj detyrimeve operative	32%	35%	30%	60%	65%	70%
Raporti i detyrimeve afatshkurtra ndaj detyrimeve totale	40%	45%	48%	90%	93%	85%

Qarkullimi i aktiveve totale	1.5 herë	1.4 herë	1.6 herë	2.2 herë	2 herë	2.1 herë
------------------------------	----------	----------	----------	----------	--------	----------

### Kërkohet:

- Komentoni strukturën financiare të të dy shoqërive duke bërë krahasimet e nevojshme mes tyre, si edhe analizën e tendencave kohore. (2 pikë)
- Jepni sugjerimet e nevojshme në lidhje me strategjinë që duhet të ndjekë secila prej shoqërive në mënyrë që të normalizojë treguesit financiarë të borxhit (detyrimeve). (2 pikë)

### Zgjidhje:

- Shoqëria Drini ka një raport të borxhit total më të lartë se niveli 50 % i cili konsiderohet pak a shumë si niveli i pranueshëm i këtij raporti, por vihet re tendenca e njësisë ekonomike për ta normalizuar raportin, pasi nga viti 2017 në vitin 2019 kemi uljen e tij. Dicka tjetër pozitive që vihet re në këtë shoqëri është fakti se detyrimet afatshkurtra ndaj atyre totale janë më pak se 50 % dhe edhe ato kanë një tendencë në rënie cka demonstroi menaxhim të mirë të detyrimeve. Për më tepër detyrimet financiare (pra hua, kredi, etj) të shoqërisë Drini janë vetëm rreth 30 % të detyrimeve operative, cka tregon edhe njëherë për një politikë të kujdesshme të saj, për të mos u ekspozuar në shumë detyrime, sidomos ato më “risikozet”, pra detyrime financiare dhe afatshkurtra.

Nga ana tjetër, shoqëria Buna ka një raport të borxhit total më afër vlerës optimale prej 50% por nuk mund të themi se ajo është në pozicion të mirë përse i përket strukturës financiare. Pra kjo nuk duhet parë në mënyrë kaq sipërfaqësore, pasi e rëndësishme është të shihet edhe struktura e detyrimeve dhe jo vetëm shuma e tyre. Më konkretisht, analiza e 2 strukturës së detyrimeve të firmës Buna zbulon që së pari ajo ka një raport tejet të lartë të detyrimeve financiare kundëjt atyre operative, dhe janë pikërisht këto detyrime financiare që janë më “problematike” pasi jo vetëm shoqërohen me interesa, por në përgjithësi kanë edhe afate shlyerje me strikte se detyrimet operative, shoqëruar me penalitete nëse nuk shlyhen brend atermave të dakordësuar.

Problemi tjetër i shoqërisë Buna është se rreth 90 % e detyrimeve të saj janë afatshkurtra, pra duhet likuiduar brenda 12 muajve që vijnë. Kjo e vendos shoqërinë në një presion të madh financiar dhe nuk e lejon të planifikojë në mënyrë të arsyeshme operacionet e saj të biznesit, pasi i duhet që çdo ditë të mendojë për shlyerjen e kësteve të shumta të detyrimeve që më së shumti janë financiare dhe janë afatshkurtra.

Nëse do krahasonim dy shoqëritë, pavarësisht se ato janë në të njëjtën fazë të ciklit të jetës dhe operojnë në të njëjtën industri, mund të themi se (pavarësisht nivelit pak më të lartë se ai optimal i borxhit total) shoqëria Drini po ia del të menaxhojë më mirë strukturën financiare të saj.

- Problemi më i dukshëm i shoqërisë Drini është raporti i lartë i borxhit total, por mund të themi se ajo është tashmë në rrugë të mbarë përse i përket menaxhimit të tij pasi vihet re tendencë rënëse e këtij raporti. Pavarësisht se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me strukturën financiare, shoqëria mundet gjithsesi të përpiqet të rrisë qarkullimin e aktiveve totale, tregues të cilin e ka dukshëm më të ulët se firma

konkurrenca. Psh nëse shoqëria shlyen një pjesë të detyrimeve të saj, kjo do sjellë rënien e pasiveve (dhe aktiveve njëkohësisht) cka jo vetëm con në rënien e raportit të borxhit total por mund të sjellë edhe rritjen e qarkullimit të aktiveve totale (nëse shitjet nuk pakësohen ndërkohë).

Për firmën Buna, problemi më emergjent që ajo duhet të zgjidhë janë detyrimet e larta financiare dhe që janë njëkohësisht edhe afatshkurtra. Sugjerohet një rinegociim me kreditorët (në këtë rast ka shumë gjasa të jenë bankat) për të konsoliduar dhe strukturuar borxhin, ndoshta për të rinegociuar termat kohorë të tij. Kjo do ulte raportin e detyrimeve afatshkurtra ndaj atyre totale pa rritur raportin e borxhit total dhe pa ulur qarkullimin e aktiveve. Me kalimin e kohës dhe me shlyerjen e këtyre borxheve do ulet edhe raporti i detyrimeve financiare ndaj atyre operative për këtë shoqëri.

3. ABC shpk është një shoqëri e prodhimit dhe e tregimit të birrës. Gjate vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2020, Abc shpk bëri publike 2 plane madhore ristrukturimi.

Plani i parë është të reduktojë sasinë prodhuese të shoqërisë duke mbyllur dy nga fabrikat e saj në rrethe. Këto fabrika janë identifikuar dhe kjo do pasohet me ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit të 50 punonjësve të cilët janë lajmëruar dhe komunikuar. Këto kosto llogariten në 2 milion Lekë, nga të cilat 1 milion për ndërprerjen e kontratës së punësimit, 0.5 milion për mbyllje të kontratave të qirasë para kohe dhe diferenca në kosto trajnimit. Plani do të zbatohet brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës.

Plani i dytë është të ridimensionojë departamentin e shpërndarjes dhe të teknologjisë së informacionit gjatë një periudhe 1 vjeçare, por ky plan do të zbatohet mbas 4 vitesh. Ky plan do të rezultojë që 40% e stafit të humbi punën dhe kostot do të jenë në 1 milion në ndërprerje marrëdhënie të punësimit, 6 milion në ritrajnime dhe 4 milion në pajisje të reja të nevojshme.

### **Kërkohet:**

Tregoni trajtimin kontabël dhe vlerën përkatëse të secilit prej të dyve planeve të ristrukturimit.

### **Zgjidhje:**

#### ***Plani 1***

Që të njihet një provizion ristrukturimi duhet që në dt e pasqyrave financiare të jetë hartuar një plan i detajuar ,ky plan të jetë bërë publikë dhe të realizohet brenda 12 muajve.Në rastin tonë:

Plani i detajuar ekziston, ku janë identifikuar fabrikat që do mbyllen. Plani është bërë publik duke ngritur pritshmëri tek palët e afektuara. Plani do të realizohet brenda 12 muajve nga data e pasqyrave financiare. Vlera përfshin kostot direkte të lidhura me mbylljen e fabrikave dhe ajo është 1.5 milion lekë. 2 pikë

#### ***Plani 2***

Në këtë rast nuk do të njohim një provizion për ristrukturim përdrisa ristrukturimi nuk pritet të zbatohet për 4 vite dhe plani mund të ndryshojë dhe manaxhimi të tërhiqet nga ky angazhim. Gjithashtu kostot e ndërprerjes së punësimit nuk janë identifikuar dhe komunikuar me palët e afektuara. 2 pikë



4. Në 1 janar 2016, shoqëria Korabi shpk nisi ndërtimin e një fabrike të re. Ndërtimi i fabrikës përfundoi në 30 shtator 2016, datë në të cilin fabrika ishte në gjendje funksionale. Kostot e lidhura me ndërtimin e fabrikës të ndodhura në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

Kosto e blerjes së tokës	36,000,000 Lekë
Kostot e çmontimit të strukturave ekzistuese	2,500,000 Lekë
Blerja e materialeve të ndërtimit të fabrikës	18,000,000 Lekë
Kostot e punëtorëve të ndërtimit	4,000,000 Lekë
Kostot administrative	1,650,000 Lekë
Kostot e shërbimeve të arkitekturës	1,115,000 Lekë
Kostot lidhur me ceremoninë e inagurimit	800,000 Lekë
Shpenzimet e interesit të huasë*	6,000,000 Lekë

\*Shoqëria financoi ndërtimet e fabrikës së re duke marrë një kredi në vlerën 60,000,000 Lekë me një normë interesi 10% në vit.

Në 1 janar 2017, shoqëria Korabi shpk investoi në një makineri të re në vlerën 26,400,000 Lekë për fabrikën e re. Jeta e dobishme e vlerësuar e impiantit është pesë vjet dhe vlera e mbetur e vlerësuar është 2,640,000 Lekë. Sipas politikave të shoqërisë, aktivi zhvlerësohet me metodën lineare. Më 31 dhjetor 2017, në përputhje me kërkesat e SNK 16 për rivlerësimin e aktivit në fund të çdo periudhe raportuese, jeta e dobishme e makinerisë u rivlerësua në tre vjet, dhe vlera e mbetur në 1,440,000 Lekë.

#### **Kërkohet:**

- Përlllogarisni vlerën kontabël të amortizueshme të fabrikës. (2 pikë)
- Përlllogarisni vlerën e zhvlerësimit të makinerisë në fund të vitit kontabël 2017, si dhe vlerën e mbetur kontabël. (1 pikë)
- Përlllogarisni vlerën e zhvlerësimit të makinerisë në fund të 3 viteve pasardhës, 2018, 2019, 2020 duke marrë parasysh ri-vlerësimin. (1 pikë)

#### **Zgjidhje:**

- a) Vlera kontabël e amortizueshme është **65,115,000 Lekë** dhe përlllogaritet si më poshtë:

<b>Kosto</b>	<b>Shuma</b>	<b>Shpjegimi</b>
Kosto e blerjes së tokës	36,000,000 Lekë	Kosto e blerjes së tokës është kosto e përfshirë në vlerën kontabël
Kostot e çmontimit të strukturave ekzistuese	2,500,000 Lekë	Kosto e përgatitjes së sitit është kosto direkte në ndërtim për të sjellë fabrikën në gjendje të gatshme për funksionim
Blerja e materialeve të ndërtimit të fabrikës	18,000,000 Lekë	Kosto direkte e përfshirë në vlerën kontabël të fabrikës

Kostot e punëtorëve	3,000,000 Lekë	9/12 x 4,000,000 Lekë; përfshihen vetëm kostot gjatë periudhës së ndërtimit
Kostot administrative	- Lekë	Vetëm kostot direkte mund të kapitalizohen
Kostot e shërbimeve të arkitekturës	1,115,000 Lekë	Konsiderohen kosto direkte dhe si të tilla kapitalizohen
Kostot lidhur me ceremoninë e inagurimit	-	Të përjashtuara nga kostot e kapitalizueshme
Shpenzimet e interesit të huasë*	4,500,000 Lekë	9/12 x 6,000,000 Lekë; përfshihen vetëm kostot gjatë periudhës së ndërtimit
<b>Total</b>	<b>65,115,000 Lekë</b>	

b) Në datën e blerjes të makinerisë, shuma e zhvlerësueshme e aktivit është 23,760,000 Lekë, pra vlera në blerje minus vlerën e mbetur (26,400,000 Lekë - 2,640,000 Lekë). Rrjedhimisht, zhvlerësimi i aktivit për vitin 2017 është 4,752,000 Lekë (23,760,000 Lekë / 5 vite). Vlera e mbetur kontabël e aktivit në fund të 2017 është 19,008,000 Lekë. **(1 pikë)**

c) Duke patur parasysh rivlerësimin e jetës së dobishme dhe vlerës së mbetur, shuma e zhvlerësueshme/ amortizueshme në fund të 2018-ës është 17,568,000 Lekë (19,008,000 Lekë – 1,440,000 Lekë); dhe kjo do të zhvlerësohet për tre vjet. Për rrjedhojë, vlerat e zhvlerësimit në 2018, 2019 dhe 2020 do të jenë 5,856,000 Lekë (17,568,000 Lekë / 3), nëse nuk ka ndryshime të ardhshme në vlerësime. **(1 pikë)**

5. TNL Sha është një njësi ekonomike e listuar, që përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara. Më 1 tetor 2007 TNL filloi një projekt për të krijuar një proces prodhimi më efikas. Shpenzimet në lidhje me projektin prej 4 milion Lekë janë njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në fund të vitit 31 mars 2008. Kostot e mëtejshme prej 1.5 milion Lekë kanë ndodhur në periudhën tre mujore deri më 30 qershor 2008. Në atë datë u bë e qartë se projekti ishte teknikisht i realizueshëm dhe komercialisht i zbatueshëm. Shpenzime të mëtejshme prej 3 milion Lekë kanë ndodhur në periudhën gjashtëmujore nga 1 korrik 2008 deri më 31 dhjetor 2008. Procesi i ri i cili filloi më 1 janar 2009, pritej të gjeneronte kursime të koston së paku 300,000 Lekë në vit gjatë periudhës 10 vjeçare, që filloi më 1 janar 2009.

#### **Kërkohet:**

a) Tregoni kriteret që duhen plotësuar për të njohur një Aktiv Afatgjatë Jomaterial, që krijohet së brendëshmi nga TNL Sha. **(2 pikë)**

- b) Tregoni për shoqërinë TNL datën në të cilën fillon kapitalizimi i këtyre shpenzimeve dhe vlerën e Aktivit Afatgjatë Jomaterial në pasqyrat financiare më datë 31 mars 2012. (2 pikë)

**Zgjidhje:**

- a) Shpenzimet për krijimin e një Aktivi Jomaterial fillojnë të kapitalizohen kur ato kryhen në fazën e zhvillimit dhe plotësohen njëherazi kushtet e mëposhtëme:
- Përfitime ekonomike të mundëshme në të ardhmen;
  - Qëllimi për të realizuar këtë AJM;
  - Burimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për ta realizuar këtë AAJM;
  - Aftësia për ta përdorur këtë AAJM;
  - Aftësia teknike për ta realizuar këtë AAJM;
  - Matja e kostos në mënyrë të besueshme. 2p
- b) Tek TNL faza e zhvillimit fillon në datën 30 Qershor 2008 dhe të gjitha kostot e mëvonshme deri në datën kur aktivi të jetë gati për përdorim (në rastin tonë data 01 Janar 2009) i kapitalizohen vlerës së tij:

Vlera fillestare e AAJM	3.000.000
<u>Amortizimi Janar 2009 - 31 Mars 2012 (39 muaj)</u>	<u>975.000 (3.000.000/10/12*39)</u>
<b>Vlera në datën e pasqyrave financiare 31/03/2012</b>	<b>2.025.000 2p</b>

6. Më 1 janar 2019 një njësi ekonomike përfitoi 500 milion Lekë nga qeveria shqiptare si një skemë nxitjeje e investimeve vendase në fushën e energjisë të rinovueshme për të ngritur një impiant prodhimi në një zonë zhvillimi. Skema e nxitjes është e kushtëzuar nga ndërtimi i impiantit në zonën e zhvillimit, përmbushja e disa kushteve specifike (përfshirë kriteret mjedisore dhe ato të sigurisë) dhe fillimi i prodhimit në ose para 31 dhjetor 2020. Nëse këto kushte nuk plotësohen, njësi ekonomike do të jetë e detyruar t'i kompensojë qeverisë të gjithë shumën e grantit prej 500 milion Lekë. Të gjitha kushtet e performancës u përmbushën më 30 mars 2020 kur njësi ekonomike filloi prodhimin e energjisë në impiant.

**Kërkohet:**

- a. Çfarë rregjistrimesh kontabël do të bëhen nga ana e njësisë ekonomike dhe kur do të bëhen këto rregjistrime. (2 pikë)
- b. Sipas kërkesave të SKK 10 "Grantet" si behet njohja dhe matja e granteve? (2 pikë)

**Zgjidhje:**

- a. Regjistrimet kontabël lidhur me grantin, sipas SKK 10, janë:

Granti qeveritar i marrë prej 500 milion Lekë duhet të njihet si detyrim më **1 janar 2019**:

D Mjete monetare 500 milion Lekë  
K Grant qeveritar 500 milion Lekë

(1 pikë)

Më 31 mars 2020, me përmbushjen e kushteve të performancës, granti qeveritar duhet të njihet në të ardhura dhe detyrimi duhet të çregjistrohet:

D Grant qeveritar 500 milion Lekë  
K Të ardhura 500 milion Lekë

(1 pikë)

7. Si bëhet njohja e aktiveve dhe detyrimeve tatimore të shtyra, ne përputhje me kërkesat e SKK 11?

### **Zgjidhje:**

Përveçse kur kërkohet nga paragrafi me poshtë, një njësi ekonomike duhet të njohë:

- (a) një detyrim tatimor të shtyrë për të gjitha diferencat e përkohshme që priten të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen;
- (b) një aktiv tatimor i shtyrë për të gjitha diferencat e përkohshme që priten të ulin fitimin e tatueshëm në të ardhmen;
- (c) një aktiv tatimor i shtyrë për mbartjen e humbjeve tatimore ose tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur

Në vijim janë përjashtime nga kërkesat e paragrafit me sipër:

- (a) Një njësi ekonomike nuk duhet të njohë një aktiv ose detyrim tatimor të shtyrë për diferenca të përkohshme të lidhura me fitimet e papaguara nga filialet e huaja, degët, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta në masën që investimi është, në thelb, i përhershëm në kohëzgjatje, përveçse kur është e dukshme që diferencat e përkohshme do të rimerren në të ardhmen e parashikueshme.
- (b) Një njësi ekonomike nuk duhet të njohë një detyrim tatimor të shtyrë për një diferencë të përkohshme të lidhur me njohjen e emrit të mirë.

Një njësi ekonomike duhet të njohë ndryshimet në një detyrim ose aktiv tatimor të shtyrë, si shpenzim tatimor në humbje ose fitim, përveç atij ndryshimi që lidhet me një zë që është njohur në kapital sipas ndonjë SKK-je tjetër, i cili duhet gjithashtu të njihet në kapital.

8. Mineral shpk merret me nxjerrjen e mineraleve bokside nga nëntoka në Shqipëri. Ky produkt shitet në Gjermani në monedhën vendase të saj (Euro). Çmimi i shitjes së produktit në Euro ndikohet nga kërkesa dhe oferta globale. Gjermania është lider botëror në tregun e këtij produkti dhe zë rreth 70 përqind të kërkesës globale. Rreth 90 përqind e kostove të inputeve të njësisë ekonomike janë për pagat e personelit shkencor dhe inxhinierë të huaj si dhe teknologjia në makineri dhe impiant përpunimi e importuar nga Gjermania. Këto kosto janë në Euro. Kostot e tjera të njësisë ekonomike janë në Lekë.

### **Kërkohet:**

- a) Cila është monedha funksionale e njësisë ekonomike? Jepni dy argumenta shpjegues për përgjigjen tuaj. (2 pikë)

- b) Si behet përkthimi ne monedhën raportuese kur kjo është e ndryshueshme nga monedha funksionale sipas kërkesave te SKK 12? (2 pikë)

### Zgjidhje:

- a) Monedha funksionale e Mineral shpk është **Euro** sipas përcaktimeve të SKK 12. (1 pikë)

Forcat e tregut në Gjermani përcaktojnë:

i. çmimin e shitjes së produkteve të njësisë ekonomike – Gjermania është kontribuesi kryesor në kërkesën e tregut global për këtë produkt dhe shitjet janë në Euro; (0.5 pikë)  
ii. kostot e inputeve të njësisë ekonomike – forcat konkurruese dhe rregullat në fuqi në Gjermani përcaktojnë kryesisht çmimin e kostos së inputeve të njësisë ekonomike (rreth 90 përqind e kostove të saj merren nga jashtë dhe përcaktohen në Euro). (0.5 pikë)

- b) Nëse monedha raportuese ndryshon nga monedha funksionale, njësi ekonomike duhet t'i përkthejë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të pozicionit financiar nga monedha funksionale në monedhën raportuese. Për shembull, kur një grup përmban njësi ekonomike individuale me monedha të ndryshme funksionale, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të pozicionit financiar të çdo njësie ekonomike shprehen në një monedhë raportuese të përbashkët në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Një njësi ekonomike, duhet të përkthejë rezultatet e saj dhe pozicionin financiar në monedhën raportuese duke përdorur procedurat e mëposhtme:

- (a) Aktivitetet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të paraqitur të pozicionit financiar (përfshirë edhe të dhënat krahasimore) duhet të përkthehen me kursin e mbylljes në datën e raportimit.  
(b) Të ardhurat dhe shpenzimet për çdo pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve (përfshirë edhe të dhënat krahasimore) duhet të përkthehen me kurset e këmbimit në datat e transaksioneve.  
(c) Të gjitha diferencat që rezultojnë nga përkthimi duhet të njihen si zë i kapitalit.

Diferencat e këmbimit që i referohen paragrafi me sipër rezultojnë nga:

- (a) përkthimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me kurset e këmbimit në datat e transaksioneve, dhe i aktiveve dhe detyrimeve me kursin e këmbimit në datën e raportimit, dhe,  
(b) përkthimi i çeljes së aktiveve neto me kursin në datën e raportimit që ndryshon nga kursi paraardhës i raportimit. Kur diferencat e këmbimit lidhen me një njësi ekonomike të huaj që është konsoliduar, por nuk është 100% e zotëruar, diferencat e akumuluar të këmbimit që lindin nga përkthimi dhe i takojnë interesit jokontrollues në njësinë ekonomike të huaj, njihen si pjesë e interesit jokontrollues në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar.

Për arsye praktike, për të përkthyer zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, një njësi ekonomike mund të përdorë një kurs që i përfaqëson kurset e këmbimit në datat e transaksioneve, për shembull një kurs mesatar për periudhën, Gjithsesi, nëse kurset e këmbimit luhaten në mënyrë domethënëse, përdorimi i një kursi mesatar për periudhën është i papërshtatshëm.

9. Sipas kërkesave të SKK 8, "Te ardhurat", për cilat veprime dhe ngjarje zbatohet ky standard, si edhe si bëhet matja e të ardhurës?

**Zgjidhje:**

SKK 8 zbatohet për kontabilizimin e të ardhurave që vijnë nga veprimet dhe ngjarjet e mëposhtme:

- (a) shitja e produkteve dhe mallrave;
- (b) kryerja e shërbimeve;
- (c) kontratat e ndërtimit në të cilat njësi ekonomike është ndërtuesi;
- (d) përdorimi i aktiveve të njësisë ekonomike nga palë të treta, nga ku gjenerohen të ardhura nga interesi, të ardhura nga shfrytëzimi i pronësisë (royalty), dhe të ardhura nga dividendët.

Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Në shumicën e rasteve pagesat bëhen në para. Kur paratë arkëtohen menjëherë ose do të arkëtohen shumë shpejt, pas kryerjes së transaksionit, të ardhurat nga shitja janë të barabarta me shumën e parave të arkëtuara ose të arkëtueshme.

10. Njësitë ekonomike A, B, C, D dhe E (pesë njësi ekonomike pa lidhje me njëra tjetrën), zotërojnë secila 20 përqind të aksioneve të zakonshme që mbartin të drejta votuese në mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve të njësisë ekonomike Z. Vendimet strategjike në njësinë ekonomike Z kërkojnë miratim nga investitorët që zotërojnë një shumicë të thjeshtë (pra më shumë se 50 përqind) të fuqisë votuese.

**Kërkohet:**

Cila nga njësitë e kontrollon njësinë ekonomike Z?

**Zgjidhje:**

Asnjë investitor i vetëm nuk e kontrollon njësinë ekonomike Z. Që të ekzistojë kontrolli i përbashkët, marrëveshjet kontraktuale do të kërkonin pëlqimin unanim mes investitorëve që ndajnë kontrollin e përbashkët. Por, marrëveshja kontraktuale lejon marrëveshje të çdo lloj kombinimi të tre prej pesë investitorëve për të marrë vendime strategjike. Në përputhje me këtë, asnjë kombinim fiks i investitorëve nuk ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike Z. Në mungesë të evidencës për të kundërtën, investitorët (njësitë ekonomike A-E) duhet t'i njohin investimet e tyre në njësinë ekonomike Z si investim në pjesëmarrje. Nëse ndonjë investitor nuk ka ndikim të rëndësishëm mbi njësinë ekonomike Z, atëherë ai do ta njohë investimin e tij në njësinë ekonomike Z në përputhje me SKK 3.

## USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)

### Ushtrimi 1

EG shpk është një shoqëri e cila operon në tregtimin me shumicë dhe me pakicë të produkteve elektroshtepiake. Shoqëria ka një program të besnikërisë ndaj konsumatorit që shpërblen konsumatorin me 1 pikë për çdo blerje prej 10 Euro. Çdo pikë mund të përdoret për 1 Euro zbritje në blerjet e ardhshme të kryera në EG shpk. Produkti me i shitur është një një zgjidhje dhe shpikje teknologjike Mini robot me vakum (MRV) i cili kryen pastrime të gjithë ambjentit të shtëpisë ose dyqaneve dhe ka një vlerë prej 100,000 Euro. Një klient blen një MRV dhe fiton 10,000 pikë. EG shpk pret që 9,500 pikë të përdoren.

### **Kerkohe:**

Sipas SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientë", tregoni trajtimin kontabël duke pasqyruar veprimet kreditore dhe debitore në njohjen e të ardhurave nga shitja e MRV-së.

### **Zgjidhje:**

Sipas SNRF 15 pg 22 "Në krijimin e kontratës, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë mallrat apo shërbimet e premtuara në kontratën me një klient dhe duhet të identifikojë si kusht performance çdo premtim për të transferuar tek klienti".

Gjithashtu, sipas SNRF 15, pg 26, në varësi të kontratës, mallrat apo shërbimet e premtuara mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, sa vijon:

(j) dhënia e opsioneve për blerje mallrash apo shërbimesh shtesë (nëse këto opsione i japin klientit një të drejtë të rëndësishme, siç përshkruhet në paragrafët B39–B43).

Për të shpërndarë çmimin e transaksionit tek çdo kusht performance në raport me çmimin specifik të shitjes, në momentin e krijimit të kontratës, njësi ekonomike duhet të përcaktojë çmimin specifik të shitjes të mallit apo shërbimit të caktuar të nënkuptuar në çdo kusht performance të kontratës dhe të shpërndajë çmimin e transferimit në përpjestim me këto çmime specifike të shitjes.

Transaksioni përfshin dy detyrime të performancës: e mira e blerë; dhe të drejtat lidhur me pikët e besnikërisë. EG shpk pret që 9500 pike do të përdoren ose 95% e cila llogaritet si 9,500 pike/ 10,000 pike në total.

Le të përcaktojmë hap pas hapi çmimin e transaksionit, të ardhurat nga shitjet dhe zbritjet për shitjet e ardhshme:

Alokimi i çmimit të transaksionit. Shoqëria duhet të alokojë paratë e arketuara mes produktit dhe mes pikeve të programit të besnikërisë:

- Vlera e zbritjeve = 9,500 pike \* 1 EUR = 9,500 EUR
- Vlera totale e transaksionit = çmimi i blerjes fillestare + opsioni i dhënë për zbritjet  
= 100,000 EUR + 9,500 EUR = 109,500 EUR

Pagesa e klientit e alokuar tek programi i besnikërisë =  $(100,000 \text{ EUR} * 9,500 \text{ EUR}) / 109,500 \text{ EUR} = 8,676 \text{ EUR}$

Pagesa e klientit e alokuar tek te ardhurat nga shitja e produktit =  $(100,000 \text{ EUR} * 100,000 \text{ EUR}) / 109,500 \text{ EUR} = 91,324 \text{ EUR}$

*\*\*2 pike do alokohen per perlllogaritjet e te ardhurave dhe programit te besnikerise.*

Trajtimi kontabël i cili pasqyron veprimet debitore dhe kreditore është si më poshtë vijon:

Debit: Paraja dhe ekuivalentet e saj/Te drejta te arketueshme	100,000 EUR
Kredit: Te ardhura nga shitja e produktit MRV	91,324 EUR
Kredit: Detyrim kontraktor (programi me pike i besnikerise se klientit)	8,676 EUR

*\*\*3 pike do alokohen per trajtimin kontabel.*

Nëse Drejtimi i Shoqërisë mund të vlerësojë në mënyrë të arsyeshme përdorimin e pikeve, do të njihte te ardhurat në të njëjtin proporcion siç njihet detyrimin për piket e besnikerise. Nëse Drejtimi nuk e përcakton në mënyrë të arsyeshme do të duhet të supozojë që përdorimin e pikeve do të jetë i plotë, pra, 10,000 pike përdorim për të siguruar që nuk do të ketë rikthime/zbritje të ardhurash në momentin e përdorimit.

## **Ushtrimi 2**

Njësia ekonomike Brunes, për vitin ushtrimor që mbyllet në 31 dhjetor 2020 ka raportuar në pasqyrat financiare të saj të dhëna si më poshtë:

- Të ardhurat nga shitjet për vitin 2020 ishin 1,500,000 Lekë;
- Fitimi neto i vitit ushtrimor 120,000 Lekë;
- Tatim-fitimi për vitin ishte 50,000 Lekë;
- Shpenzimet e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale ishin 80,000 Lekë;
- Aktivet totale në fund të vitit 2020 ishin 1,400,000 Lekë;
- Norma e interesave të detyrimeve financiare për vitin 2020 ishte 6%. Shoqëria ka detyrime financiare (detyrime që mbartin interes), sa gjysma e detyrimeve totale të saj. Kurse raporti i borxhit total të saj është 55%.

### **Kërkohet:**

- a) Llogarisni dhe komentoni vlerën e kthimit mbi aktivet totale (mbështetuni në vlerën e aktiveve totale në fund të vitit 2020). (2 pikë)
- b) Llogarisni dhe komentoni vlerën e kthimit mbi kapitalin aksionar total (mbështetuni në vlerën e kapitalit aksionar në fund të vitit 2018). (2 pikë)
- c) Komentoni diferencat mes treguesve të llogaritur në lërlesat a dhe b më lart. Përse mendoni se vjen ky ndryshim?. (1 pikë)

### **Zgjidhje:**

- a)  $\text{Kthimi mbi aktivet totale} = \text{Fitimi nga aktiviteti i shfrytëzimit} / \text{Aktivet totale}$

$\text{Ku Fitimi nga aktiviteti i shfrytëzimit} = \text{Fitimi neto} + \text{Tatim fitimi} + \text{Shpenzime interesi}$



Pra Fitimi nga aktiviteti i shfrytëzimit =  $120.000 + 50.000 + 6 \% \times 0.55 \times \frac{1}{2} \times 1.400.000 = 193.100$  lekë

Kthimi mbi aktivet totale =  $193.100 / 1.400.000 = 13,79\%$

Kjo do të thotë se për cdo 100 lekë të investuara në aktivitetet e saj, kjo shoqëri merr si kthim 13.79 lekë. Nëse e krahasojmë me normën e interesave të huasë (6%), mund të themi se kjo shoqëri ka mundur të shfrytëzojë me efektivitet investimet e saj pasi ka arritur të gjenerojë më shumë kthim nga sa do të duhet të ripaguajë kreditorët e vet.

b) Kthimi mbi kapitalin total = Fitimi neto / Kapitali

Ku Kapitali është 45 % e aktiveve (meqë raporti i borxhit total është 55 %).

Kthimi mbi kapitalin total =  $120.000 / 630.000 = 19,05 \%$

Kjo do të thotë se për cdo 100 lekë të investuara në aktivitetet e saj, aksionarët e kësaj shoqërie marrin si kthim afro 19 lekë.

Zakonisht kthimi mbi kapitalin krahasohet me normat e interesit të depozitave bankare (ose nëse është e mundur me ndonjë normë tjetër kthimi pa risk). Fakti që kthimi mbi kapitalin 19 % është dukshëm më i lartë se kthimi nga depozitat, demonstroi shfrytëzim me përfitim të fondeve të aksionarëve pasi ata përftojnë ndjeshëm më shumë sesa do të përftonin nëse fondet që kanë investuar në këtë biznes ti kishin investuar në një formë pa risk, ose më mirë të themi me risk të ulët, sic janë depozitat në banka.

c) Fakti që kthimi mbi kapitalin është më i lartë se kthimi mbi aktivet tregon se shoqëria ka arritur të shfrytëzojë me avantazh jo vetëm investimet por edhe strukturën financiare të saj, për t'u sjellë përfitimin pronarëve, pra aksionarëve.

Pra ndryshimi vjen për shkak të faktit se njësi ekonomike ka ditur t'i japë vlerë jo vetëm investimeve të saj (duke marrë kthim mbi aktivet prej 13,79 % dukshëm më lart se normat e interesit 6 %), por ka ditur si të menaxhojë edhe strukturën financiare pasi është pikërisht shfrytëzimi me avantazh i levës financiare që shkakton diferencën mes dy treguesve të kthimit.

### **Ushtrimi 3**

Shoqëria BGE Sha ka në kontabilitetin e saj një ndërtesë të mbajtur sipas modelit të rivlerësimit. Ndërtesa ka një vlerë kontabël neto të rivlerësuar prej 37 milion Lekë në 1 janar 2011 dhe një jetë të dobishme të mbetur prej 20 vjetësh (dhe 1 milion Lekë vlerë te mbetur). Më 1 gusht 2014, aseti plotësonte kriteret për tu klasifikuar si i mbajtur për shitje. Vlera e saj e drejtë ishte 40 milion Lekë dhe shpenzimet për të shitur ishin 1 milion Lekë në atë datë.

**Kërkohet:**

- a) Tregoni trajtimin kontabël gjatë kësaj periudhe dhe tregoni rregjistrimet ne kontabilitet. (2 pikë)
- b) Tregoni kriteret që duhet të plotësohen që një aktiv të klasifikohet si i mbajtur për shitje dhe paraqitjen e tij në pasqyrat financiare. (2 pikë)

**Zgjidhje:**

Llogarisim amortizimin nga data 01 Janar 2011 deri në datën 1 Gusht 2014 (pra për 43 muaj perdorim) datë në të cilën ndërtesa plotëson kriteret për tu klasifikuar si një aktiv i mbajtur për shitje dhe ndalon llogaritja e amortizimit:  $(37.000.000/20/12) * 43 = 6.629.167$  lekë. 1 pikë

Vlera kontabël Neto e ndërtesës në datën 01 Gusht:

Ne datën 01 Gusht vlera e drejtë e ndërtesës është 40.000.000 lekë. Pra kemi një rivlerësim në rritje për diferencën:  $40.000.000 - (37.000.000 - 6.629.167) = 9.629.167$  lekë. 1 pikë

Në datën kur klasifikohet si i mbajtur për shitje ndërtesa vlerësohet me më të voglën midis kostos (në këtë rast tashmë është 40.000.000 lekë) dhe VNR (Çmim shitje - Kosto për të realizuar shitjen):  $40.000.000 - 1.000.000 = 39.000.000$  lekë. 1 pikë

Pra ndërtesa në këtë datë ndryshon klasifikim, paraqitet në seksionin e aktiveve afatshkurtra me vlerën 39.000.000 lekë. 1 pikë

Kushtet që të klasifikohet si aktiv i mbajtur për tu shitur (IFRS5): 1 pikë

Çmimi i shitjes i arsyeshëm/- Nuk ka gjasa që kompania të tërhiqet nga shitja/ Drejtimi i angazhuar për ta realizuar shitjen/ - Plan marketing/- Shitja pritet të realizohet brenda 12 muajve.

Zbatohen kërkesat e IFRS 5, nuk amortizohet, AASH, klasifikohet më vete, çdo datë vlerësohet mos i ka rënë vlera, pra krahasojmë vlerën në kontabilitet me VNR.

**Ushtrimi 4**

Pasqyra e fitimit/humbjes të shoqërisë BCG Sha për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2020 ishin si më poshtë:

**BCG Sha**

**PASQYRA E FITIMIT/HUMBJES PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

	‘000 Lekë	‘000 Lekë
Shitjet		720
Lëndë të para	70	
Shpenzime për stafin	94	
Amortizimi	118	
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e AAGJ	18	
		300
Fitimi operativ		420

Shpenzim interesi	28
Fitimi para tatimit	392
Tatim fitimi	124
Fitimi i Vitit	268

### **BCG Sha**

#### **PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR**

	2020	2019
	‘000 Lekë	‘000 Lekë
<b>Aktivet Afatgjata</b>		
Kosto	1,596	1,560
Amortizimi	(318)	(224)
	<u>1,278</u>	<u>1,336</u>
<b>Aktivet Afatshkurtra</b>		
Inventari	24	20
Llogari të arkëtueshme	76	58
Banka	48	56
	<u>148</u>	<u>134</u>
<b>Total aktive</b>	<u><u>1,426</u></u>	<u><u>1,470</u></u>
<b>Kapitali dhe detyrimet</b>		
<b>Kapitali</b>		
Kapitali aksionar	360	340
Prim i Aksioneve	36	24
Fitime të mbartura	716	514
	<u>1,112</u>	<u>878</u>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
Hua afatgjata	200	500
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Llogari të pagueshme	12	6
Detyrime tatimore	102	86
	<u>114</u>	<u>92</u>
<b>Total kapitali dhe detyrime</b>	<u><u>1,426</u></u>	<u><u>1,470</u></u>

Informacion shtesë:

Gjatë vitit, shoqëria pagoi 90,000 Lekë për një pjesë të re makinerie.

#### **Kërkohet:**

Përgatitni pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për BCG Sha për aktivitetin operativ për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020 duke përdorur metodën indirekte.

### Zgjidhje:

Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiviteti Operativ:

Fitimi para tatimit	392 (0.5p)
Shpenzime amortizimi	118 (0.5p)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e AAGJ	18 (0.5p)
Ndryshimi i llogarive të arkëtueshme	(18) (58-76) (0.5p)
Ndryshimi i inventarit	(4) (20-24) (0.5p)
Ndryshimi i llogarive të pagueshme	6 12 – 6 (0.5p)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga AO</b>	<b>512</b>
Tatimi i paguar	(108) (1p)
Divident i paguar	(66) (0.5p)
<b>Mjete monetare neto nga AO</b>	<b>338 (0.5p)</b>

Tatimi i paguar (detyrim tatimor 2001 + tatim fitmi i vitit - detyrim tatimor 2002);

Divident i paguar (fitimi i pashpërnadarë 2001 + fitim neto 2002 - fitimi i pashpërnadarë 2002)

### Ushtrimi 5

Në 1 janar 2020 shoqëria Omega shpk hyn në marrëdhënië qiraje pesë vjeçare, në cilësinë e qiramarrësit, për një makineri me jetë ekonomike 8 vjet. Omega shpk do të kryejë pagesa të barabarta prej 240,000 Lekë të pagueshme në 1 janar të çdo viti, duke filluar nga 1 janar 2020, datë në të cilën nis marrëdhënia e qiramarrjes. Vlera e drejtë është 960,000 Lekë. Vlera aktuale e pagesave të ardhme të qirasë është 729,000 Lekë. Norma e interesit e nënkuptuar në marrëveshjen e qirasë është 12% në vit.

### Kërkohet:

Si duhet të kontabilizohet kjo qira në pasqyrën e pozicionit financiar të Omega shpk më 31 dhjetor 2020 në përputhje me SNRF 16? Jepni përlllogaritjet tuaja.

### Zgjidhje:

Paraqitja në Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020 është:

#### **AKTIV**

##### *Aktive Afatgjata*

Aktiv me të drejtë të përdorimit.....775,200 Lekë (2 pikë)

#### **PASIV**

##### *Detyrime Afatgjata*

Detyrimi i qirasë.....576,480 Lekë (2 pikë)

### ***Detyrime Afatshkurtra***

Detyrimi i qirasë.....240,000 Lekë (1 pikë)

Përlllogaritjet:

### **AKTIVI**

#### **E drejta e përdorimit të aktivit**

Vlera aktuale e pagesave të ardhshme të qirasë..... 729,000 Lekë

Plus pagesa fillestare në 1 janar 2020..... 240,000 Lekë

**E drejta e përdorimit të aktivit.....969,000 Lekë**

Minus Amortizimi vjetor i qirasë/ pjestuar për 5 vite..(193,800) Lekë

**Vlera kontabël (31 dhjetor 2020).....775,200 Lekë**

E drejta e përdorimit të aktivit jepet si total i vlerës aktuale të pagesave të ardhshme të qerasë, plus pagesën fillestare prej 240,000 e kryer në formë parapagimi në momentin e nënshkrimit të kontratës, minus amortizimin vjetor. E drejta e përdorimit të aktivit amortizohet për 5 vite, pra koha më e shkurtër mes kohështirjes së qerasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

### **PASIVI**

#### **Detyrimi i qirasë**

Vlera aktuale në çelje (1 janar 2020).....729,000 Lekë

Plus Interesi vjetor (729,000 Lekë x 12%).....87,480 Lekë

**Detyrimi total i qerasë .....816,480 Lekë**

Minus vlera e qirasë e pagueshme në avancë.....(240,000) Lekë

**Detyrimi afatgjatë i qirasë (31 dhjetor 2020).....576,480 Lekë**

Duke filluar nga data 01 janar 2020 dhe përgjatë kohështirjes 5-vjecare të kontratës, Omega do të kryejë 5 pagesa të barabarta qeraje në vlerën 240,000 Lekë secila. Detyrimi në pasqyrat financiare shprehet përmes vlerës aktuale në çelje plus interesin vjetor të përlllogaritur me normën e nënkuptuar në marrëveshjen e qerasë. Detyrimi total pasqyrohet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, si një detyrim afatshkurtër, pra kësti i dytë në vlerën 240,000 Lekë i pagueshëm në 01 janar 2021 dhe detyrimin afatgjatë që është diferenca midis detyrimit total dhe deetyrimit afatshkurtër.

Kandidati duhet të paraqisë veçmas detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata të qerasë. Në rast të përlllogaritjes së saktë të detyrimit total por mosprezantimit të drejtë në detyrim afatshkurtër dhe afatgjatë, kandidati do të përfitojë vetëm 1 pikë.

### **Ushtrimi 6**

Shoqëria A shpk po ndërton nga 1 qershori 2019 dy ndërtesa: një qendër zyrash dhe një qendër tregtare në Tiranë. Këto ndërtime ajo nuk do t'i shesë por do t'i mbajë për dhënie me qera dhe administrim prej vetë asaj. Për këto ajo ka marrë hua bankare nga OTP; përkatësisht për ndërtesën e parë 2 milion Euro dhe për ndërtesën e dytë 5 milion Euro. Interesat e huasë janë 10% në vit.

Në janar të vitit 2020 për shkak të shirave ka ndërprerë punën në themelet e qendrës tregtare të cilat janë përmbytur dhe po hiqen ujërat. Kjo ndodhë zakonisht në Tiranë në këtë periudhë. Në prill 2020 rifilloi puna për ndërtimin. Kurse ndërtesa e qendrës së zyrave në shtator të vitit 2020 është bllokuar nga policia ndërtimore dhe çështja është në gjykatë. Çështja pritet të zgjidhet në favor të shoqërisë A brenda muajit mars 2021. Në datën 31 të muajit tetor të vitit 2021 përfundoi ndërtimi, kostot direkte sipas faturave të nënkontraktorëve ishin 8 milion Euro, taksa e infrastrukturës 500 mijë euro, shpenzimet e hipotekimit 40,000 Euro. Po në tetor 2021 dhe shoqëria A filloi përdorimin e tyre për zyrë dhe duke dhënë me qira ambientet në qendrën tregtare. Vlera e drejtë në datën 31 dhjetor 2021 e ndërtesave ishte 14 milion Euro.

### **Kërkohet:**

- a) Tregoni si do të klasifikohen ndërtesat nga A shpk? Argumentoni përgjigjen? ( 2 pikë)
- b) Si do ti vlerësojë Shoqëria A ndërtesat në njohjen fillestare ( 1.5 pikë) dhe në pasqyrat financiare të saj? ( 1.5 pikë). Shpjegoni përgjigjen tuaj.

### **Zgjidhje:**

1. Klasifikimi i ndërtesave do të përcaktohet nga qëllimi i përdorimit. Nëse njësia A do të përdoret për të dhënë me qira këto ndërtesa, atëherë ato do të klasifikohen si AAMI. Kjo sepse njësia ekonomike i mban ato për të dhënë me qira dhe sipas SNK 40, aktivet afatgjata të tipit toka dhe ndërtesa që jepen me qira klasifikohen si AAMI. Sepse sipas SNK 40 fluksi i të ardhurave prej tyre identifikohet qartë nga aktivet e tjera Nëse ndërtesën e detyrohet të përdoret për qëllime administrative të saj, pra për vehte, ndërtesa për qendër tregtare do të klasifikohet si AAMI, (SNK 40) kurse ndërtesa e detyrohet të klasifikohet si AAM e pronarit (SNK 16) ( **2 pike**)
2. Në njohjen fillestare ndërtesat do të vlerësohet me kosto. Në kosto do të përfshihen të gjitha kostot direkte të kryera deri në datën e përfundimit të ndërtimit, pra  $8\text{ mil} + 0.5\text{ mil} + 0.04\text{ mil} = 8,540,000$  euro. Kësaj kosto duhet të shtohet dhe kostoja e interesave gjatë ndërtimit deri në momentin e përfundimit të ndërtimit. Kostoja e interesave për huan 2 mil euro të marre për ndërtesën për qendrën tregtare llogaritet për periudhën nga 1 qershor 2019 deri në 31 tetor 2021, (Interesat nga 1 janar 2020 deri në 1 prill 2020 duke qenë se shirat ndodhin zakonisht në këtë periudhë në Tiranë sipas SNK 40, do të përfshihen në koston e ndërtimit dhe kapitalizimi i interesave nuk pezullohet). Në koston e ndërtesës për qëllime administrative do të llogariten interesat për gjithë periudhën e ndërtimit për huan 5 mil përveçse nuk do të përfshihen interesat e huas gjatë periudhës që ka qenë e bllokuar nga policia ndërtimore, pra nga shtator 2020 deri mars 2021. ( **1.5 pike**)
3. Në PF të saj Shoqëria A mund të mbaje ndërtesat me modelin e vlerës së drejtë ose me koston të amortizuar. Nëse i mban vlerësimin me kosto, duhet të japë informacion për vlerën e drejtë për AAMI. (SNK 40) Nëse i vlerëson me VD, për plusvlerën e rivlerësimit për AAMI duhet të njohë në këtë rast një fitim në rezultatin e periudhës, ndërsa për AAM të pronarit (SNK 16) diferenca e rivlerësimit do të paraqitet në kapitalin e vetë dhe në pasqyrën e të ardhurave totale ( **1.5 pike**)

## Ushtrimi 7

Altea shpk operon në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve. Aktiviteti i saj përpunues ka impakt direkt në mjedis. Sipas politikës së saj mjedisore të publikuar, Altea angazhohet të rimbjellë pemë për të balancuar dëmet mjedisore të krijuara nga veprimtaria e saj. Altea shpk ka një histori të qëndrueshme të respektimit të kësaj politike. Gjatë 2020, Altea shpk hapi një fabrikë të re, duke çuar në disa dëmtime mjedisore. Shoqëria vlerëson se dëmi mjedisor do të kushtonte 4,000,000 Lekë në mbjellje të reja për të balancuar impaktin negativ.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020, për shkak të një defekti në sistemet e sigurisë së një makinerie, një nga punonjësit dëmtohet rëndë. Punonjësi vendos të hedhë në gjyq shoqërinë, duke pretenduar dëmshpërblim në vlerën 4,500,000 Lekë pasi ky dëm i ka shkaktuar punonjësit një pamundësi të përkohëshme për të punuar. Avokatët e Altea shpk vlerësojnë se probabiliteti që shoqëria të humbasë gjyqin është 85% dhe se dëmshpërblimi do të jetë i pagueshëm brenda 1 viti. Kosto e kapitalit është 8%. Në vitin 2021, gjykata vendos në favor të punonjësit duke detyruar shoqërinë Altea shpk të dëmshpërblejë brenda vitit punonjësin në masën 4,500,000 Lekë.

### **Kërkohet:**

- a) Cila është vlera e provigjionit që duhet të njohë shoqëria në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 duke patur parasysh që nuk ka asnjë kuadër ligjor që detyron shoqërinë të dëmshpërblejë dëmin mjedisor. Argumentoni përgjigjen tuaj (2 pikë)
- b) Llogarisni vlerën e provigjionit që duhet të njohë shoqëria në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 lidhur me dëmshpërblimin ndaj punonjësit, duke marrë parasysh vlerën në kohë të parasë. (1 pikë)
- c) Tregoni rregjistrimet kontabël për vitin 2020 dhe 2021 lidhur me detyrimet e mundshme ligjore që mund të vijnë si pasojë e çështjes gjyqësore me punonjësin. (2 pikë)
- d) Cila është vlera e provigjionit që duhet të njohë shoqëria në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 duke patur parasysh që nuk ka asnjë kuadër ligjor që detyron shoqërinë të dëmshpërblejë dëmin mjedisor. Argumentoni përgjigjen tuaj (2 pikë)
- e) Llogarisni vlerën e provigjionit që duhet të njohë shoqëria në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 lidhur me dëmshpërblimin ndaj punonjësit, duke marrë parasysh vlerën në kohë të parasë. (1 pikë)
- f) Tregoni rregjistrimet kontabël për vitin 2020 dhe 2021 lidhur me detyrimet e mundshme ligjore që mund të vijnë si pasojë e çështjes gjyqësore me punonjësin. (2 pikë)

### **Zgjidhje:**

Edhe nëse nuk ka kuadër ligjor apo rregullativ që e detyron Altea shpk të mbjellë pemët për të balancuar efektet negative të dëmit ambjental, shoqëria sërisht do të ketë një **detyrim konstruktiv**. (0.5 pikë) Altea tashmë ka krijuar pritshmëri për të bërë një gjë të tillë si pasojë e **publikimit të politikës mjedisore**, duke ndërmarrë kështu një angazhim, si dhe **praktika e konsoliduar e të shkuarës**. (1 pikë)  
Në këtë rast vlera e provigjionit do të jetë **4,000,000 Lekë**. (0.5 pikë)

a) Provigjioni i pasqyruar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në këtë rast kërkohet të marrë parasysh vlerën në kohë të parasë. Rrjedhimisht, ky provigjion do të jetë 4,166,667 Lekë; pra 4,500,000 Lekë, pjestuar për 1.08 (bazuar në koston e kapitalit dhe afatit të pagesës prej 1 vit). (1 pikë)

b) Regjistrimet kontabël, përkatësisht për vitin 2020, dhe 2021 do të jenë:

Për vitin 2020 (1 pikë):

D Shpenzime lidhur me çështjet gjyqsore	4,166,667 Lekë
C Provigjione lidhur me çështjet gjyqsore	4,166,667 Lekë

Pra, në vitin 2020, Altea shpk duhet të njohë në librat kontabël një provigjion lidhur me çështjen gjyqsore për shkak të probabilitetit të lartë që kjo të përfundojë në favor të punonjësit.

Për vitin 2021 (1 pikë):

D Provigjione lidhur me çështjet gjyqsore	4,166,667 Lekë
D Shpenzime financiare	333,333 Lekë
C Mjete monetare	4,500,000 Lekë

Pra, me zgjidhjen e çështjes në favor të punonjësit, shoqëria kryen pagesën prej 4,500,000 Lekë. Në këtë rast kemi çregjistrim të provigjionit; njohjen e një shpenzimi financiar të barabartë me diferencën mes pagesës dhe provigjionit të njohur sipas vlerës në kohë të parasë si dhe kreditim të mjeteve monetare.

Kandidati do të vlerësohet me 2 pikë dhe në rastin kur nuk ka marrë parasysh vlerën në kohë të parasë në trajtimin kontabël. Pra, në këtë rast veprimet do të jenë:

Për vitin 2020 (1 pikë):

D Shpenzime lidhur me çështjet gjyqsore	4,500,000 Lekë
C Provigjione lidhur me çështjet gjyqsore	4,500,000 Lekë

Për vitin 2021 (1 pikë):

D Provigjione lidhur me çështjet gjyqsore	4,500,000 Lekë
C Mjete monetare	4,500,000 Lekë

## **Ushtrimi 8**

11. Pam sha është një njësi ekonomike e listuar që përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara. Pam i paraqet aktivet afatgjata duke përdorur modelin e rivlerësimit kudo që është e mundur sipas SNRF. Gjatë vitit financiar që përfundoi më 31 mars 2009, Pam sha hyri në transaksionet e mëposhtme:



- a) Më 1 prill 2008 Pam sha bleu një degë të re, Map sha. Drejtorët e Pam sha kryen veprimet e nevojshme siç kërkohet nga SNRF 3 Kombinimet e Biznesit dhe arriti në përfundimin se emri i markës së Map Sha kishte një vlerë të drejtë prej 10 milion Lekë dhe ka të ngjarë të gjenerojë përfitime ekonomike për një periudhë 20-vjeçare nga 1 prilli 2008.
- b) Ata më tej konkluduan se ekspertiza e punonjësve të Map Sha kontribuoi 5 milion Lekë në vlerën e përgjithshme të Map Sha. Jeta mesatare e vlerësuar e mbetur e shërbimit të punonjësve të Map Sha ishte tetë vjet nga 1 prilli 2008.
- c) Më 1 tetor 2008 Pam Sha rinovoi licencën për nxjerrjen e mineraleve që nevojiten si pjesë e procesit të prodhimit. Kostoja e rinovimit të licencës ishte 200,000 Lekë dhe licenca është për një periudhë pesë vjeçare duke filluar nga 1 tetori 2008. Nuk ka treg aktiv për këtë lloj licensë. Megjithatë, drejtorët e Pam Sha vlerësuan se në 31 mars 2009 vlera e drejtë minus kostot për shitjen e licencës ishte 175,000 Lekë. Ata vlerësuan më tej se gjatë 54 muajve të mbetur të kohëzgjatjes së saj, licenca do të gjeneronte flukse neto të parasë për Pam Sha që kishin një vlerë aktuale më 31 mars 2009 prej 185,000 Lekë.

### **Kërkohet:**

Shpjegoni se si Pam Sha duhet të trajtojë transaksionet e mësipërme në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin deri në 31 mars 2009?

### **Zgjidhje:**

Duke filluar nga 01 prill 2008 Pam sha do të njoh një Aajm Marka në vlerën 10 milion leke, I cili do të amortizohet për një periudhë 20 vjeçare . Plotësohen të gjitha kriteret e të njohurit një Aajm pasi kemi të bëjmë me një aktiv të identifikueshem, Kontrolllohet nga Pam sha ,Kosto matet në mënyrë të besueshme dhe pritët të gjenerojë përfitime ekonomike në të ardhmen. 1.5 pikë

Ekspertiza e punonjësve nuk njihet si një aktiv i jomaterial pasi njësia ekonomike nuk ka kontrollin mbi këta punonjës. 1 pikë

- a) Pam sha në tetor 2008 një AAJM Licenca pasi plotëson kriteret sa më lart. Për këtë aktiv llogarisim amortizim në 31 mars 2009 në vlerën  $200.000/60*5=16667$  leke. Vlera e mbetur në këtë datë është 183.333 leke. Në këtë datë kemi informacion që vlera e realizueshme është 175000 leke ndërsa vlera në përdorim është 1850000 leke, që do të thotë që vlera e rikuperueshme është 185.000 leke. Përdorimi i këtyre vlerave është me e madhe se Vlera e mbetur në kontabilitet me kosto atëherë Licenca nuk është zhvlersuar dhe nuk ka nevojë për veprim në kontabilitet për ta reflektuar këtë. 2.5 pikë

### **Ushtrimi 9**

Një njësi ekonomike (operatori) lidh një marrëveshje me qeverinë vendore (dhënësi i konçesionit). Sipas kushteve të marrëveshjes operatori duhet të ndërtojë një spital brenda 3 viteve dhe ta mirëmbajë dhe ta drejtojë spitalin për 27 vjet (pra. vitet 4-30), sipas standardeve të caktuara nga qeveria.

Kushtet e marrëveshjes kërkojnë që operatori t'ia japë spitalin dhënësit të konçesionit në fund të vitit të 30. Spitali duhet të jetë operacional në fund të vitit 30, kur përfundon marrëveshja. Kushtet e pagesës së marrëveshjes kërkojnë që dhënësi i konçesionit ta paguajë operatorin

100,000 Lekë në vitin 4, shumë që rritet me një normë vjetore prej 3 përqind në vitet 5-30, kur spitali i vihet në dispozicion publikut.

**Kërkohet:**

Si duhet të trajtohet marrëveshja?

**Zgjidhje:**

Operatori njih të ardhura dhe kosto nga kontrata në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Kostot dhe të ardhurat e çdo aktiviteti – si fillim ndërtimi i spitalit dhe pastaj funksionimi i spitalit - njihen si të ardhura dhe shpenzime duke iu referuar fazës së përfundimit të këtij aktiviteti. Spitali nuk paraqitet si pronë (aktiv) e operatorit.

Edhe pse dhënësi i konçesionit i bën pagesa operatorit vetëm kur operatorit e vë në funksionim spitalin, në vitet 4 deri 30, këto pagesa në thelb përfaqësojnë kompensimin si për shërbimet e ndërtimit ashtu edhe ato për funksionimin e saj. Shumat për t'u paguar nga dhënësi i konçesionit (në lidhje me punën ndërtimore) përmbushin kushtet e përkufizimit të një llogarie të arkëtueshme në SKK 3 Instrumentet financiare. Llogaria e arkëtueshme matet fillimisht me vlerën e drejtë; në fund të vitit 1 ajo përfaqëson vlerën e drejtë të punës ndërtimore të bërë në atë vit. Ajo matet më pas me koston e amortizuar në përputhje me SKK 3 Instrumentet financiare, d.m.th. llogaria e arkëtueshme matet çdo vit duke marrë parasysh vlerën kontabël nga viti i mëparshëm, normën e interesit dhe arkëtimet gjatë vitit.

**Ushtrimi 10**

Shoqëria A.B.B. shpk është një shpërndarës me shumicë i pajisjeve elektrike. Shoqëria ka të ardhura mesatare vjetore prej 15,000,000 Lekë dhe aktive totale 12,000,000 Lekë. Administratori i shoqërisë është duke shqyrtuar një draft-raport, i cili ndër të tjera përmban edhe një përmbledhje të treguesve financiare të shoqërisë për tre vitet e fundit 2018-2020 si më poshtë:

<b>Treguesi i analizës financiare</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Raporti korrent	2.5	2.3	2.1
Raporti i shpejtë	0.8	1.1	1.5
Qarkullimi i inventarit	3.8	4.8	5.25
Raporti i borxhit total	38%	41%	44%
Raporti detyrime afatshkurtra/detyrime totale	19%	22%	25%
Kthimi mbi aktivet totale	8.7%	8.6%	8.5%
Kthimi mbi kapitalin	14.1%	14.6%	15.1%

Në këtë pikë, administratori i shoqërisë A.B.B kërkon disa sqarime nga shefi i financës për të kuptuar më shumë mbi raportet financiare, domethënien e tyre për drejtimin e shoqërisë dhe mënyrën sesi ato lidhen me njëra-tjetrën.

**Kërkohet:**

- a) Vihet re se raporti korrent vjen në rritje kurse raporti i shpejtë në rënie. Përse mund të ndodhë një situatë e tillë? (1 pikë)
- b) Sipas raporteve financiare të mësipërme që shpjegojnë strukturën financiare të shoqërisë, çfarë vihet re për përdorimin e borxhit në periudhën 2018-2020? (2 pikë)
- c) Kthimi mbi aktivet totale është duke u rritur me një ritëm të lehtë, ndërkohë që kthimi mbi kapitalin është në rënie. Cilat janë arsytet që mund të vihet re një fenomen i tillë? (2 pikë)

### Zgjidhje:

- a) Cfarë bën diferencën mes raporti korrent dhe atij të shpejtë është inventari. Nëse raporti korrent rritet ndërkohë që raporti i shpejtë është në rënie, kjo tregon rritjen e peshës së inventarit në strukturën e aktiveve afatshkurtra të njësisë ekonomike. (rritja e inventarit mund të konfirmohet lehtësisht edhe nga rënia e treguesit të qarkullimit të inventarit).
- b) Nga raporti i borxhit total i cili vjen në rënie në këtë hark kohor (nga 44 % në 38 %), kuptojmë se njësia ekonomike ka mundur të menaxhojë mirë shumën dhe strukturën financiare duke ulur masën e detyrimeve totale të saj. Ajo jo vetëm ka një raport të borxhit total nën nivelin 50% që konsiderohet si niveli optimal i strukturës së kapitalit, por tenton të zvogëlojë më tej këtë raport. Kjo në përgjithësi konsiderohet një menaxhim i kujdesshëm i strukturës financiare.  
Gjithashtu vihet re se pjesa që zënë detyrimet afatshkurtra në detyrimet totale gjithashtu është pakësuar në vitet 2018 – 2020 nga 25% në 19%. Edhe kjo nënkupton një menaxhim të mirë të strukturës financiare, pasi jo vetëm borxhi në total është ulur, por edhe pjesa "më emergjente" e borxhit, e cila duhet likuiduar brenda më pak se 12 muajve, është pakësuar gjithashtu.  
Të dy këto raporte demonstrojnë ruajtjen e një ekuilibri të kujdesshëm të strukturës financiare, POR, ndoshta ulja e mbështetjes në borxh dhe pakësimi i shfrytëzimit të levës financiare MUND të sjellë rënie të kthimit për aksionarët (dicka që ndodh shpesh në rastet kur nuk shfrytëzohen mjaftueshem fondet e huajtura).
- c) Cfarë përbën diferencën mes kthimit mbi aktivet dhe kthimit mbi kapitalin është avantazhi (ose disavantazhi) i shfrytëzimit të levës financiare, pra me sa përfitim (ose jo) për llogari të pronarëve të njësisë ekonomike, kemi mundur të shfrytëzojmë fondet e huajtura.  
Në të treja vitet vërehet se kthimi mbi kapitalin është më i lartë se kthimi mbi aktivet, cka tregon se fondet e huajtura po shfrytëzohen me avantazh, POR vihet re se diferenca mes treguesve po ngushtohet duke demonstruar pakësimin e mbështetjes në detyrime, dicka e konstatuar edhe në kërkesën 2 më lart.  
Fakti që kthimi mbi aktivet po rritet vazhdimisht tregon se njësia ekonomike po i shfrytëzon investimet në aktivet totale të saj me rentabilitet të konsiderueshëm; nga ana tjetër rënia e kthimit mbi kapitalin, pavarësisht se vazhdon të mbetet më i lartë se kthimi mbi aktivet, tregon se shoqëria duhet të shfrytëzojë situatën e mirë të interesave në treg dhe të përdorë pak më tepër borxh për të marrë avantazh nga shfrytëzimi i fondeve të huajtura.